

BETONRID

Mjet për pastrim të mbetjeve të suvasë, betonit, lëngut të çimentos, yndyrave dhe shtresave me korrozion të ulët të sipërfaqeve të metalit. Nuk përmban bashkime klori dhe nuk i dëmton sipërfaqet metalike

Fusha e aplikimit:

BETONRID është i dedikuar për pastrim të pajisjes së dedikuar për prodhim të betonit. Mënjanon në mënyrë efikase pikat dhe shtresat nga lëngu i çimentos, suva dhe beton, e në të njëjtën kohë i pastron shtresat e yndyrshme dhe të korrozionit në sipërfaqet. Aplikimi përfshin pastrim të mikserëve të betonit, të pompave të betonit, kibla, skele metalike, kallëpe metalike dhe pajisje tjetër metali.

Cilësi:

- Mënjanues i shtresave të çimentos;
- Në mënyrë efikase i mënjanon shtresat e yndyrave në sipërfaqe betoni dhe metali;
- E mënjanon korrozionin nga sipërfaqet të metalit;
- Nuk është agresiv për çelikut;
- Është ekonomik për përdorim;

Karakteristika teknike:

Përbërja:	Acide jo-organike, materie aktive në sipërfaqe
Dukje:	Lëng i ngjyrosur i tejdukshëm
Pesha specifike:	1,26 ± 0,03 g/cm ³
pH-faktor:	1

Mënyrë e përdorimit dhe veprimi:

Betonrid përmban substanca të cilat reagojnë me mbetjet e betonit dhe suvasë në pajisjen për prodhim dhe punë, ndërsa në të njëjtën kohë në mënyrë efikase i mënjanon shtresat e yndyrshme dhe korrozive në sipërfaqen. Vendoset në mbetjet të betonit me furçë të fortë, fërkohet vazhdimisht, lihet të qëndrojë ashtu, e mandej shpëlahet me ujë të pastër.

Rezik për jetën: BETONRID përmban acide organike, për shkak të të cilit duhet të shmanget kontakti me lëkurën dhe sytë. Gjatë punës duhet të përdoret veshje përkatëse mbrojtëse, doreza dhe syze. Nëse vjen në kontakt me sytë nevojitet që menjëherë të shpëlahen me curril të ujit të pastër dhe të kërkohet ndihmë mjekësore. Nëse gëlltitet, nevojitet që menjëherë të kërkohet ndihmë mjekësore. Nevojitet që shmanget kontakti të mjetit me sipërfaqe të zinkut dhe aluminit. Në rast të kontaktit me këto metale mund të lirohet hidrogjen dhe formim të përzierjes shpërthyes në hapësira të mbyllura.

Zjarr: BETONRID është lëng që nuk ndizet. Pastrimi i mbetjeve të BETONRID bëhet me ujë. Ambalazhi i vjetër i përdorur duhet të deponohet sipas dispozitave dhe rregullatave lokale për atë lloj të mbetjeve. Nuk guxon të ndodh derdhje e drejtpërdrejtë e mjetit në ujëra natyrore dhe në ujërat rrjedhëse.

Sasia e përdorur dhe koha e veprimit varet nga trashësia, vjetërsia dhe lloji i shtresave – lëngu i çimentos, damka nga suvaja, shtresat e betonit dhe yndyrrosje të mëdha.

Për shtresa të betonit ose të suvasë së çimentos me trashësi më të mëdha prej 1 cm., paraprakisht është e nevojshme që mekanikisht të thyhen (me ndihmë të një objekti të fortë , furçë çeliku, shpahëll dhe ngjashëm) e mandej vendoset BETONRID. Sipas nevojës procedura e pastrimit (vënia e mjetit dhe shpëlarja) përsëritet disa herë , sipërfaqja vazhdimisht fërkohet (me furçë ose ngjashëm), ndërsa mjeti përdoret drejtpërdrejtë duke mos u holluar. Për damka nga suvaja dhe lëngu i çimentos, BETONRID mund të hollohet me ujë në raport 1:1 deri 1:3 pjesë ujë. Me rëndësi është që pas përfundimit të pastrimit, sipërfaqja të shpëlahet me ujë të pastër. BETONRID nuk është agresiv ndaj çelikut, përkatësisht për pajisjen e punuar nga çeliku dhe i pastron mirë sipërfaqet me yndyrë dhe me korrozion.

Kur përdoret për pastrimin e sipërfaqeve me yndyrë BETONRID aplikohet me furçë të thjeshtë me të cilën sipërfaqja fërkohet dhe në fund shpëlahet me ujë të pastër. Te shtresat e korrozionit pas vënies (me furçë ose ngjashëm) lihet të ashtu disa minuta, ndërsa më vonë fërkohet mirë dhe në fund lahet me ujë të pastër. BETONRID përdoret për pastrim të sipërfaqeve të zinkuara metalike dhe ato nga alumini. Duhet të kihet kujdes gjatë pastrimit të makinave-pompa ose të mikserëve, të mos përmbajnë materiale të tilla.

Paketimi:

Ambalazh plastik: 1.2;6 dhe 24 kg.

Vendosja në depo:

Në ambalazh origjinal, të mbyllur, në temperaturë prej 5°C deri 40°C. Hapësirat në të cilat ruhet duhet gjithmonë të jenë të ajrosura mirë, ndërsa ambalazhi të jetë i mbyllur
Afati i përdorimit: 12 muaj.